REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 450/26 Dt. 22.09.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik i plotësuar me Rregulloren 002/2024 për Prokurim Publik, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për amendamentimin e kontratës

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për amendamentimin (ndryshimin) e kontratës për projektin: "Ndërtimi i kanalizimit të hapur, mureve mbrojtëse dhe rregullimi i rrugicave në fshatin Krushë e Vogël"-projekt dy vjeçar me nr. 622-24-154 -511, i cili është duke u realizuar nga GOE –"Flori" shpk, "Joos& Krasniqi-Baze" shpk.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Sektorit të Prokurimit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.